



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 147 prot.

Kamëz, më 5.11.2024

V E N D I M
Nr. 109 .Datë 5.11.2024
M B I

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR DJEGIE BANESE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 05.11.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.70 Datë 21.10.2024 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;; Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”;; VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë nr.835, datë 03.09.2024, dhe nr.7514, datë 12.09.2024 për evidentimin, konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesë, relacionit të hartuar nga ekspertët e administratës së Bashkisë në zbatim të urdhërave, dhe V.K.B. Kamëz Nr. 103, datë 18.12.2023 “Për miratimin e detajuar të buxhetit për vitin 2024 dhe planit të buxhetit për vitet 2024 ; 2025, dhe 2026, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për djegie banese të:

z , për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 19.08.2024;
znj., për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 31.08.2024.

2. Miratimin e dokumentacionit tekniko – ligjorë hartuar në formën e kriterëve në relacion, sipas preventivave të komisionit të vlerësimit të dëmeve hartuar nga ekspertët e administratës së Bashkisë Kamëz, në zbatim të Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të konstatimit dhe vlerësimit të dëmtimeve të shkaktuara në banesën e z dhe znj.”.

3. Të akordohet një ndihmë financiare për këto familje sipas tabelës më poshtë:

| Nr | Emër Atësi Mbiemër | Vlera e dëmit lekë | Për pagesë, 50% e vlerës në lekë, sipas VKM-së nr. 329, dt. 16.05.2012 |
|----|--------------------|-----------------------|--|
| 1 | | 511,663 | 255,831 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

| | | | |
|---|---------------|------------------|----------------|
| 2 | | 895,716 | 447,858 |
| | TOTALI | 1,407,379 | 703,689 |

4. Ndihma financiare për familjet e dëmtuara përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.
5. Kjo shumë prej 703,689 (shtatëqind e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI